



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 30.07.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Raport mbi informacionin e kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Janar – Qershor 2020, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ilir Toska.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Raport mbi informacionin e kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Janar – Qershor 2020, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

*Naureda Llagami:* Përshëndetje të gjithëve.

Duke qenë se anëtarët janë të pranishëm, përveç zotit Toska, i cili për shkak të një fatkeqësie familjare është në pamundësi sot për të qenë në mbledhjen e ditës së sotshme.

Siç jeni në dijeni nga rendi i ditës, kemi pesë çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga ana e Këshillit.

Fillimisht është Raport mbi informacionin e kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën Janar – Qershor. Kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin kapital të disa aseteve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, te Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë”. Kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”. Kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}” dhe së fundi shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në nivel apeli, të gjyqtarit {...}”.

Atëherë, pa humbur kohë, fillojmë tek çështja e parë e cila do të relatohet nga zonja Brikena Ukperaj. Brikena, për ty fjala!

*Brikena Ukperaj:* Faleminderit!

Të nderuar anëtarë!

Raporti që i paraqitet sot mbledhjes plenare ka të bëjë me një përpunim të informacionit të përcjellë nga kryetarët e gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore, për periudhën janar-qershor 2020, në zbatim të vendimit nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore” si dhe vendimit nr. 115, datë 09.07.2019, po të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të të cilit është miratuar formulari tip, mbi bazën e të cilit do të dërgohej ky informacion.

Bazuar në këtë bazë ligjore, nga ana e të gjithë kryetarëve të gjykatave janë dërguar pranë Këshillit informacionet periodike mbi bazë tremujore. Sipas një praktike të ndjekur tashmë, informacionet periodike të kryetarëve të gjykatave janë trajtuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Fillimisht këshilltarja ligjore që asiston këtë Komision, znj. Alsma Shehu ka përpunuar informacionin dhe përgatitur memon, e cila i është përcjellë anëtarëve të këtij Komisioni me qëllim evidentimin e raportimin në Mbledhje Plenare jo vetëm të problematikave të raportuara por edhe të sugjerimeve përkatëse.

Komisioni vlerëson të sjellë në vëmendje të Mbledhjes Plenare se, tashmë pas rreth 1 vit e gjysmë ushtrim veprimtarie të këtij Këshilli, është e nevojshme të ndryshohet dhe unifikohet mënyra e raportimit nga ana e gjykatave, sipas metodologjisë së përdorur për raportimin 1-vjeçar të Këshillit. Unifikimi i mënyrës së raportimit do ta bëjë më të lehtë përpunimin e informacionit jo vetëm për efekt të raportimit 1-vjeçar që Këshilli bën para Kuvendit, por edhe për efekt të monitorimit e vazhdueshëm të çështjeve që lidhen me veprimtarinë gjyqësore, brenda kompetencave të KLGJ-së, tashmë që është ngritur edhe ILD-ja. Prandaj është e nevojshme që për 6-mujorin e ardhshëm formati i raportimit të ndryshohet për sa i përket përmbajtjes, me qëllim raportimin jo vetëm të treguesve që lidhen me ngarkesën e gjykatave e të gjyqtarëve, por edhe atyre që lidhen me matjen e efikasitetit e cilësisë në dhënien e drejtësisë, sikundër janë: norma e efikasitetit, raporti i qarkullimit të çështjeve, koha e nevojshme për përfundimin e çështjeve, etj., tregues këta që janë përdorur edhe nga Këshilli në raportimin e tij 1-vjeçar.

Për këtë 6-mujor, përsëri informacioni periodik është përpunuar nga KVEVP-ja, dhe po ju paraqitet për informim në formën e një raporti që përfshin periudhën 6-mujore 01.01.2020-30.06.2020.

Lidhur me çështjen e parë që ka të bëjë me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatën dhe çdo gjyqtar të saj, evidentimi i numrit të çështjeve të mbartura nga vitet paraardhëse, si dhe numri i çështjeve të zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile, respektivisht për secilën shkallë gjykimi, janë përgatitur anekset 1 dhe 2, të cilat ju janë dërguar bashkëngjitur këtij raporti. Konkretisht, lidhur me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe çdo gjyqtar, për 6-mujorin e parë, Aneksi nr. 1 është hartuar në një formë tabelare. Përmban të dhëna për secilën gjykatë lidhur me:

- a) Numrin e çështjeve të mbartura në datë 01.01.2020 (pra çështjet e mbartura nga viti paraardhës);
- b) Numrin e çështjeve të reja të regjistruara nga 01.01.2020 deri më 30.06.2020;
- c) Numrin e çështjeve të gjykuara nga data 01.01.2020 deri më 30.06.2020;
- d) Numrin mesatar të çështjeve të gjykuara për gjyqtar;
- e) Numrin e çështjeve në shqyrtim deri më datë 30.06.2020;
- f) Numrin e çështjeve në shqyrtim mesatarisht për secilin gjyqtar.

Nuk dua të ndalem në përmbajtjen e tabelave sepse me ato jeni njohur dhe janë bashkëngjitur këtij raporti në formën e të dhënave tabelare.

Gjithashtu, në relacion ka edhe një tabelë të posaçme, në të cilën janë evidentuara numrat e çështjeve të gjykuara mesatarisht për secilin gjyqtar për këtë 6-mujor, si dhe numri i çështjeve në shqyrtim mesatarisht për secilin gjyqtar, po për këtë 6-mujor, duke i ndarë gjykatat në gjykata të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të apelit, gjykatat e posaçme të shkallës së parë, ajo për korrupsionin dhe krimin e organizuar, gjykatat administrative të shkallës së parë dhe një rubrikë e posaçme që i përket gjykatës së posaçme të apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe një tabelë më të detajuar paraqitet gjendja në gjykatën e apelit administrativ, e cila vazhdon përsëri të paraqesë të njëjtën problematikë (siç edhe shikohet nga tabela) në diferencimet jo vetëm të ngarkesës së gjyqtarëve por edhe të çështjeve të përfunduara nga secili prej tyre.

Lidhur me situatën në Gjykatën e Lartë, Gjykata e Lartë raporton një “backlog” (deri në datën 30.06.2020) prej 35,530 çështjesh. Për këtë 6-mujor, nga raportimi i fundit, kemi konstatuar që janë gjykuar 429 çështje të ndara më poshtë sipas kolegjeve, ndërkohë

që në këtë numër nuk përfshihen gjykimet e kërkesave për pezullimet civile dhe administrative, të cilat sipas raportimit janë në total 322 kërkesa të shqyrtuara. Nga përmbajtja e tabelës së statistikave, rezulton që kjo gjykatë, për 6-mujorin e parë të vitit 2020, të ketë dhënë 751 vendime, 429 shqyrtime dhe 322 gjykime kërkesa për pezullim.

Për sa i përket përmbajtjes së të dhënave tabelare për 6-mujorin e parë të vitit 2020 lidhur me ngarkesën e çështjeve gjyqësore për gjykatë dhe për çdo gjyqtar, konstatohet se: në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Mat, Pukë dhe Tropojë edhe pse nuk kanë një organikë të plotë, raportohet numri më i vogël i çështjeve të përfunduara për gjyqtar si dhe ngarkesa më e vogël për gjyqtar, mesatarisht 60 çështje; gjykatat Përmet, Dibër, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lushnje, Pogradec, edhe pse me organikë jo të plotë, raportojnë një ngarkesë mesatare nga 100-120 çështje për gjyqtar, por numri mesatar i çështjeve të përfunduara për gjyqtar në këto gjykata ndryshon me diferenca të konsiderueshme; gjykatat Berat, Kavajë, Durrës, Lezhë, Tiranë dhe Vlorë kanë ngarkesën mesatare për gjyqtar më të madhe, e cila varion nga 140-242 çështje për gjyqtar. Ngarkesën më të madhe e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me 242 çështje për gjyqtar, me një organikë prej 3 gjyqtarësh (ku 1 është i përhershëm dhe 2 të transferuar), e cila ka gjithashtu një normë mesatare të lartë të përfundimit të çështjeve për këtë 6-mujor, që shkon 176 çështje të gjykata për gjyqtar; normën mesatare më të lartë të përfundimit të çështjeve e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me 247 çështje për gjyqtar si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje me 241 çështje për gjyqtar.

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të posaçëm, duke filluar me Gjykatën Administrative Korçë dhe Gjirokastrë, të cilat kanë organike të plotë prej 4 gjyqtarësh, paraqesin ngarkesë afërsisht të njëjtë, po kështu edhe normë mesatare afërsisht të njëjtë të përfundimit të çështjeve për gjyqtar. Kjo normë mesatare rezulton e lartë krahasuar me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, e cila edhe pse me organike të plotë që prej janarit 2020, raporton një normë mesatare çështjesh të përfunduara prej 84 (afërsisht gjysma e gjykatave të tjera) dhe një ngarkesë mesatare për gjyqtar prej 340 çështje, që është në fakt një vlerë e lartë, që nuk gjendet në asnjë prej gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, duke marrë parasysh që kjo është edhe një gjykatë e posaçme, ku shpejtësia e gjykimit të çështjeve është prioritet.

Situatë problematike paraqet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës e cila raporton një ngarkesë mesatare aktuale prej 553 çështje për gjyqtar, por ka normë mesatare të përfundimit të çështjeve shumë herë më të ulët se ajo e gjykatave të tjera (me 55 çështje për gjyqtar). Për këtë 6-mujor të parë kjo gjykatë raporton vetëm 166 çështje të përfunduara dhe 1660 çështje në shqyrtim. Në këtë gjykatë, ngarkesa për gjyqtar është rezulton si më poshtë dhe është paraqitur në format tabelar. Ajo që vihet në dukje është që ndoshta për herë të parë, që në momentin kur ne kemi filluar funksionimin, një gjykatë administrative e shkallës së parë, na rezulton që një gjyqtar të ketë një ngarkesë prej 721 çështje.

Edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë raporton ngarkesë prej 260 çështje për gjyqtar, por ka përfunduar për këtë 6-mujor shqyrtimin e 586 çështjeve.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka numrin më të lartë të çështjeve të përfunduara prej 1250 çështje, por kjo Gjykatë punon me organikë të plotë prej 16 gjyqtarësh, me një ngarkesë aktuale që ajo e ruan në mënyrë periodike prej 105 çështje për gjyqtar.

Situata në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, është e njëjtë ashtu sikurse edhe në tremujorin e parë dhe për tremujorin e dytë të vitit 2020. Ngarkesën më të madhe e ka Gjykata e Apelit Tiranë me një normë mesatare prej 690 çështje për shqyrtim për gjyqtar, deri në datën 30.06.2020, ndërkohë që Gjykatat e Apelit Korçë dhe Gjirokastrë kanë ngarkesë disa herë më të ulët.

Gjykata e Apelit Durrës raporton 2570 çështje që presin për t'u shqyrtuar në datën 01.07.2020, Gjykata e Apelit Vlorë 3451 çështje, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë 12 422 çështje.

Normën mesatare më të lartë të përfundimit të çështjeve për gjyqtar relator e ka Gjykata e Apelit Vlorë me 123 çështje për gjyqtar, ndërsa atë me të ulët Gjykata e Apelit Gjirokastrë dhe Gjykata e Apelit Korçë me 61 çështje për gjyqtar, si dhe Gjykata e Apelit Tiranë me 67 çështje të përfunduara për gjyqtar.

Problematike paraqitet situata në Gjykatën e Apelit Administrativ, ku siç del edhe nga tabela e detajuar më lart, ka një numër shumë të lartë të çështjeve në shqyrtim deri në datën 30.06.2020 për gjyqtar, si dhe një disbalancë të theksuar të ngarkesës midis gjyqtarëve.

Çfarë sugjeron Komisioni për përmirësimin e situatës?

Së pari, përsheptimi i miratimit të hartës gjyqësore e cila do të mundësonte një ndarje të barabartë të ngarkesës midis gjykatave dhe rritjen e efektivitetit të tyre;

Së dyti, veç plotësimit të vendeve të tjerave vakante, vijimin sa më shpejt me lëvizjet paralele dhe ngritjet në detyrë, të cilat do të ndikonin në uljen e ngarkesës në gjykatat të cilat kanë ngarkesë të papërbalueshme të tilla si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Administrativ (duke marrë parasysh që kjo e fundit mbetet jashtë hartës gjyqësore);

Ndërtimin e strategjive për uljen e “backlog”-ut në gjykatat e apeleve, veç plotësimit të vendeve vakante, një prej të cilëve do të ishte vlerësimi i situatës që duhet të bëjë Këshilli lidhur me ndihmësit ligjorë (ata që vazhdojnë në gjykatat administrative të shkallës së parë si dhe ata që mbarojnë Shkollën e Magjistraturës), kryesisht për Gjykatën e Apelit Tiranë dhe atë të Apelit Administrativ, që raportojnë edhe numrin më të madh të çështjeve të mbartura për vitin 2020. Reduktimi i numrit të gjyqtarëve në gjykatat e apeleve, për shkak të procesit të vetingut ka filluar të prodhojë “backlog” edhe në këto gjykata, në të cilat ka jo vetëm rritje të numrit të çështjeve të mbartura nga viti i mëparshëm, por në duke edhe ulje të normës së përfundimit të çështjeve, edhe pse nga një konstatim i thjeshtë duket që numri i çështjeve të reja të regjistruara në këto gjykata nga 01.01.2020 nuk është i lartë.

Në lidhje me “backlog”-un në Gjykatën e Lartë, ai është në shifrën 35 530 çështjeve. Këshilli ka filluar ndërtimin e strategjive të veta për uljen e këtij “backlog”-u dhe rifunksionalizimin e Gjykatës së Lartë. Nuk do ndalem sepse ne tashmë kemi miratuar Memorandumin e Bashkëpunimit (përmendet edhe në relacion); gjithashtu kemi vijuar procedurën për shpalljen e pozicioneve të lira dhe kemi rënë dakord edhe për prioritetet dhe afatet për rifunksionalizimin e kësaj gjykate në udhërrëfyesin e diskutuar ditën e djeshme.

Lidhur me çështjet e zvarritura tej afateve të arsyeshme të përcaktuara në nenin 399/2 të K.Pr.Civile, gjykatat që kanë një numër të madh të tyre, janë:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhoma civile, me 851 çështje;

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me 10 150 çështje;

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës 386 çështje;

Gjykata e Lartë 21 682 çështje. Në këtë gjykatë nga totali i çështjeve që presin për gjykim prej 35 530 çështje, 21 682 çështje tashmë e kanë kaluar afatin e arsyeshëm sipas nenit 399/2 të K.Pr.Civile (në referim të Aneksit nr. 2 që i bashkëngjitet këtij raportit).

Nga të dhënat e pasqyruara në këtë aneks konstatohet lehtësisht se gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm nuk raportojnë për çështje të zvarritura tej afateve të arsyeshme sepse i referohen vetëm çështjeve që kanë përfshirë në kalendarin e gjykimit (pra çështjet që janë në gjykim). Në raportimet e mëtejshme, me ndryshimin e përmbajtjes edhe të formularit të raportimit, këtyre gjykatave duhet t'iu kërkohet që për këtë rubrikë të raportojnë vonesat në shqyrtim, që nga momenti i regjistrimit të çështjeve në gjykatën e apelit, sikundër ato raportojnë edhe për ngarkesën e gjyqtarëve.

Ndërkohë vlerësohet që Këshilli duhet të shpejtojë me miratimin e udhëzuesve për mbajtjen e statistikave gjyqësore, sikundër u miratua udhëzuesi për efekt të vlerësimit profesional. Matja e efikasitetit të gjykatës, nuk lidhet vetëm me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, por ka indikatorë të tjerë matjeje dhe vlerësimi. Është e domosdoshme të unifikohen tashmë, me efekt për vitin 2021, regjistrat e regjistrimit të çështjeve sipas kategorive si dhe mënyra e mbajtjes dhe raportimit të statistikave gjyqësore, detyrim ky i parashikuar nga neni 94 i ligjit nr. 115/2016.

Nga informacioni që jepet nga të gjitha gjykatat, arsyet e zvarritjes së çështjeve, ashtu si dhe në raportimet paraardhëse, lidhen kryesisht me arsye procedurale siç janë: pezullim, marrje provash, letër porosi, vendimmarrje nga Gjykata e Lartë, por edhe ngarkesa e çështjeve, e cila vjen duke u rritur për shkak të mungesës të gjyqtarëve nga largimet prej procesit të rivlerësimit kalimtar. Gjithashtu, gjykatat raportojnë zvarritje të çështjeve si pasojë e situatës së krijuar për shkak të pandemisë në të gjithë vendin.

Lidhur me respektimin e etikës dhe solemnitetit nga trupa gjyqësore, nga ana e kryetarëve të gjykatave nuk raportohet të ketë problematikë.

Lidhur me numrin e kërkesave për heqje dorë të miratuara nga kryetarët e gjykatave për çdo gjyqtar si dhe të vendimeve për përjashtim gjyqtari të pranuar me kërkesë të palëve për shkak të konfliktit të interesit, në lidhje me këto konstatohet se ka një numër relativisht të madh të kërkesave për heqje dorë nga ana e gjyqtarëve. Shkaku i këtyre dorëheqjeve apo përjashtimeve, nuk evidentohet në fakt në pjesën më të madhe të



raportimeve edhe pse sipas formularit të miratuar është kërkuar që të jepet shkak që lidhet me to.

Nga informacioni i ardhur vihet re një numër shumë i madh i kërkesave për heqje dorë të pranuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier me 95 kërkesa; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan 220 kërkesa; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me 127; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë me 52 kërkesa; Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin me 59 kërkesa, Gjykatën e Apelit Tiranë me 128 kërkesa; Gjykatën e Apelit Vlorë me 180 kërkesa; Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, me 99 kërkesa. Arsyeja e këtij numri, siç edhe është raportuar më parë, kryesisht lidhet me një problem teknik që ka lidhje me sistemin e menaxhimit të çështjeve, ICMIS që përdorin këto gjykata. Sipas shpjegimit të kryetarëve, ky sistem nuk i lejon të përjashtojnë paraprakisht nga shorti i gjykimit të themelit të një çështjeje penale, gjyqtarin e hetimit paraprak apo atë të seancës paraprake.

Siç edhe është sugjeruar në raportimet e mëparshme, kjo e dhënë tregon përsëri për një tjetër problem të funksionimit të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve, që e kemi diskutuar dhe raportuar edhe herë të tjera në Këshill. Një pjesë e kësaj problematike, siç është sugjeruar, mund të zgjidhet edhe nëpërmjet miratimit të rregullave të mënyrës së ndarjes së çështjeve me short, p.sh. duke shmangur automatikisht gjyqtarët e hetimit paraprak apo seancës paraprake nga gjykimi i themelit, etj.

Nga raportimet konstatohet se numri i vendimeve për pranimin e kërkesave për përjashtim të gjyqtarit është shumë i vogël në raport me kërkesat për dorëheqje, megjithatë përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, vihet re një numër i konsiderueshëm: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me 34 kërkesa të pranuar për përjashtim gjyqtari konflikt interesi si dhe Gjykata e Apelit Tiranë me 24 kërkesa të pranuar.

Lidhur me funksionimin e sistemit të regjistrimit audio dhe nivelit të përdorimit të tij si dhe paraqitjes në përqindje të numrit të seancave gjyqësore që janë regjistruar në sistemin audio apo atyre që janë mbajtur me mjete të tjera (kompjuter dhe dorëshkrim). Është Aneksi nr. 3 që i bashkëngjitet raportit.

Në përdorimin e sistemit të regjistrimit audio të seancave gjyqësore, vihet re që ka diferenca të mëdha midis gjykatave. Në raportim nuk jepen shume shpjegime për arsyet e mospërdorimit por nga ajo që kuptohet, shkaku kryesor i përqindjes së ulët të seancave të cilat regjistrohen nëpërmjet audios, është mungesa e sallave ku të mund të zhvillohen gjykimet. Në lidhje me këtë situatë, ajo që sugjerohet është studimi i situatës në të gjitha gjykatat dhe mundësia për të ndërhyrë me investime në gjykatat ku numri i sallave përkundrejt numrit të gjyqtarëve është shume i vogël. Nga informacioni i përcjellë, konstatohet që gjykata me përqindjen më të ulët të përdorimit të sistemit të regjistrimit audio, mbetet Gjykata Rrethit Gjyqësor Tiranë, me 20.08 %. Gjithashtu, në këtë tregues ndikojnë edhe seancat gjyqësore që zhvillohen në dhoma këshillimi, të cilat ulin përqindjen e përdorimit të sistemit audio.

Në lidhje me informacionin për fillimin e seancave me vonesë nuk raportohet problematikë nga gjykatat e shkallës së parë. Në gjykatat e apeleve raportohet një numër më i madh i seancave të filluara me vonesë, ku ashtu si dhe në raportimet e mëparshme, japin edhe arsyet e vonesave, të cilat lidhen me shkaqe që nuk varen nga gjyqtarët por kanë të bëjnë kryesisht me faktin e zgjatjes së seancave pararendëse, vonesat e paraqitjes së palëve, shoqërim i të pandehurve, vonesat e avokatëve dhe prokurorëve.

Gjendja e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve, së bashku me nevojat e konstatuara për përditësimin e këtij sistemi (Aneksi nr. 4).

Për sa i përket përdorimit dhe problemeve të hasura në përdorimin e sistemit të administrimit të çështjeve, konstatohet se, pothuajse të gjithë gjykatat që përdorin sistemin ICMIS, parashtrojnë të njëjtën problematikë, problematikë kjo që nuk është e re, por është e njëjtë edhe me atë të raportimeve të mëparshme. Në mënyrë të detajuar, bashkë me propozimet përkatëse, iu është njoftuar anëtarëve të Këshillit nga z. Muharremaj, në kuadër të grupit të punës së ngritur për studimin e sistemeve të menaxhimit të çështjeve në gjykata. Deri në miratimin e një sistemi të ri të unifikuar të menaxhimit të çështjeve, sugjerohet që të shihet me prioritet mirëmbajtja e sistemeve që aktualisht kemi. Problematikat e raportuara si dhe sugjerimet e gjykatave pasqyrohen në Aneksin nr. 4.

Lidhur me vonesat në dorëzimin e vendimeve të arsyetuara, raportohet se vetëm nga 15 gjykata ka raste të vonesave të tilla. Një pjesë e tyre shoqërohet edhe me

shpjegimin e shkaqeve kryesore të vonesave, por ndërkohë që nuk raportohet asnjë rast që të ketë sjellë pasoja për palët.

Lidhur me problematika të tjera të evidentuara në raportime që kanë lidhje me veprimtarinë gjyqësore, si dhe sugjerimet përkatëse për zgjidhjen e tyre - Në lidhje me informacionin që kërkohet sipas shkronjës “g” të vendimit, që ka të bëjë më raportimin e çdo problematike tjetër të evidentuar, nga 38 gjykata, 23 prej tyre kanë përcjellë probleme, ku spikat ngarkesa e papërbalueshme dhe numri shumë i lartë i çështjeve për të cilat gjyqtarët caktohen të gjykojnë në gjykata të tjera. Problematikat e tjera janë evidentuar në Aneksin nr. 5 dhe që në mënyrë të përmbledhur i adresohen:

Së pari, infrastrukturës së gjykatave:

- a) mungesës së hyrjeve të veçanta për palët;
- b) mungesës së sallave për zhvillimin e gjykimeve;
- c) lirimit të ambienteve të tjera që ndodhen brenda së njëjtës godinë ku ushtron veprimtarinë gjykata, por që janë në përdorim të institucioneve të tjera si Shërbimi i Provës, Prokuroria apo Shërbimi Përmbartimor dhe vënia e tyre në përdorim të gjykatave;
- d) mungesës së ambienteve të posaçme dhe të përshtatshëm për t’u krijuar mundësinë palëve në gjykim apo avokatëve të tyre për t’u njohur me dosjen nën vëzhgimin e sekretareve gjyqësore.

Problematika i adresohet arkivave të gjykatave, mungesës së ambienteve të përshtatshme dhe numrit shumë të madh të dosjeve;

Pamjaftueshmërisë së stafit administrativ në kryesekretari për shkak të rritjes së volumit të punës si pasojë e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile;

Shërbimit postar, vështirësisë për komunikimin e njoftimeve dhe vendimeve tek viktimat, kallëzuesit, personat që u atribuohet vepra penale etj., kur viktimat kanë ndërruar jetë ose kanë ndryshuar adresë;

Vështirësisë në hartimit në mënyrë manuale të statistikave gjyqësore për shkak të mos gjenerimit të këtyre të dhënave statistikore nga sistemi ICMIS sikundër sistemi ARK-IT. Mungesa e një punonjësi të specializuar në përpunimin e të dhënave statistikore.

Plotësimit të gjykatave të apelit me ndihmës ligjorë.

Miratimit sa me parë të organigramave të gjykatave dhe përshkrimit të punës për çdo kategori;

Miratimin e akteve nënligjore të nëpunësit civil gjyqësor, me qëllim plotësimin e nevojave për shërbime mbështetëse në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore dhe administrimit të gjykatave, një nevojë kjo që na është prezantuar edhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

Nevojës për trajnim të gjyqtarëve për çështjet që lidhen me zbatimin e së drejtës së ankimit në gjykimin e urdhrave të mbrojtjes.

Veç sa më sipër, për Gjykatën e Apelit Durrës dhe atë të Rrethit Gjyqësor Lezhë, problematika e mëparshme që lidhet me mungesën e godinës vazhdon, sepse të dyja këto gjykata nuk kanë aktualisht një godinë të tyre dhe vazhdojnë të shfrytëzojnë ambiente të tjera për ushtrimin e funksioneve dhe shërbimeve gjyqësore. Kjo nuk garanton sigurinë në gjykata, sjell vështirësi në zhvillimin e proceseve gjyqësore dhe përmbushjen e detyrave nga nëpunësit gjyqësorë.

Ashtu si dhe në raportimet e mëparshme, pavarësisht se një pjesë e problematikës së mësipërme që lidhet me stafin administrativ e infrastrukturën e gjykatave do të marrë zgjidhje me hartën e re gjyqësore, deri në zbatimin e kësaj të fundit, bërja funksionale e godinave të Gjykatës së Apelit Durrës e asaj të Rrethit Gjyqësor Lezhë, duhet të mbikëqyret me prioritet nga ana e Këshillit.

Faleminderit për kohën!

*Naureda Llagami:* Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, ne siç kemi vijuar në të gjithë rastet e tjera që thjesht ju i prezantoni një informacion mbledhjes plenare. Nuk besoj se kemi nevojë për vendimmartje. Janë problematika mbi të cilat që të gjithë ne duhet të reflektojmë, mbi situatën që kanë gjykatat dhe propozimet që ju parashtruat.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 30.07.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin kapital të disa aseteve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, te Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ilir Toska.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin kapital të disa aseteve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, te Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë”, përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për transferimin kapital të disa aseteve, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, te Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë”.

Siç jeni në dijeni, aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke u transferuar në godinën e re “Poli i Drejtësisë”. Në vijim të këtij procesi si dhe bazuar edhe shprehjen e interesit nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, është vlerësuar transferimi pa pagesë i disa aseteve të llojit orendi, pajisje zyrash, tavolina pune, poltrona, karrige, dollapë.

Për këtë arsye është përgatitur nga stafi administrativ një projekt-akt mbi kalimin e këtyre dhe për më shumë detaje, do doja që t’ia jepja fjalën zotit Haxhiu.

*Xhevdet Haxhiu:* Të nderuar anëtarë!

Siç e tha edhe Kryetarja, në vijim të procesit të transferimit të institucionit tonë nga godina ekzistuese për tek godina e re e “Polit të Drejtësisë” si dhe shprehjes së interesit që ka bërë Zyra e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, kemi vlerësuar, mbas një procesi që kemi bërë me strukturën përgjegjëse të administrimit të pasurisë në institucionin tonë, kemi vlerësuar transferimin e disa aseteve, pa pagesë, në drejtim të Zyrës së Inspektorit të Lartë i Drejtësisë. Këto asete kanë të bëjnë veçanërisht me orendi

dhe pajisje zyresh, siç janë tavolinat e punës, poltronat, karriget, dollapët, etj., të cilat kanë qenë në përdorim, sigurisht prej një kohe shumë të gjatë në institucionin ekzistues tonin por që vitet e punës kanë bërë të tyren, por që janë në gjendje të mirë pune dhe për të mos i çuar dëm këto... se siç dihet zyrat tona atje janë të pajisura me pajisje dhe orendi zyre nga institucioni përgjegjës që ka në administrim zyrat e reja, kështu që ne kemi bërë një listim të këtyre aseteve që kemi në institucionin ekzistues.

Pas vlerësimit, struktura përgjegjëse është gjithashtu edhe në procesin e vlerësimit të disa aseteve, pas mbylljes së procesit të inventarizimit periodik vjetor të pasurisë së institucionit dhe shkakut të transferimit për tek “Poli i Drejtësisë”. Ne jemi edhe në procesin e vlerësimit të aseteve edhe për nxjerrjen jashtë përdorimit, që po përgatitet nga dy grupet e punës të cilët janë ngritur si për vlerësimin ashtu edhe për vlerësimin për nxjerrjen nga përdorimi dhe vazhdon procesi i punës dhe së shpejti do paraqiten përpara Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Planifikimit të Buxhetit dhe mbledhjes plenare.

Për sa më sipër, në zbatim të VKM nr. 153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, të Ministrisë së Financave, ne vlerësojmë transferimin kapital pa pagesë të aseteve orendi dhe pajisje zyre (sipas pasqyrës bashkëlidhur) që sot janë në pronësi të KLGJ-së, për t’u kaluar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë i Drejtësisë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Miratimin e transferimit kapital pa pagesë të aseteve orendi dhe pajisje zyre (sipas pasqyrës bashkëlidhur) deri më sot në pronësi të KLGJ-së, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë i Drejtësisë. 2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 30.07.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ilir Toska.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen e radhës e cila ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 20.07.2020 është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit.

Ndërkohë më datë 23.07.2020, pranë Këshillit, është depozituar një kërkesë tjetër nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar që dorëheqja e tij nga statusi i magjistratit të shqyrtohet dhe të jepet me efekte të menjëhershme, bazuar në nenin 65, pika 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Si motiv të dorëheqjes së tij, z. {...} ka parashtruar faktin se nga ana e strukturave drejtuese të Partisë Demokratike Lezhë dhe njëkohësisht të Partisë Demokratike Tiranë është propozuar për të qenë kandidat i mundshëm për zgjedhjet e ardhshme politike në Qarkun Lezhë. Në këto kushte ai ka kërkuar shqyrtimin e kërkesës së parevokueshme me efekt të menjëhershëm.

Në nenin 64 dhe nenin 65 të ligjit nr. 96/2016 rregullohet pikërisht kjo situatë juridike, rastet e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak të dorëheqjes. Në nenin 65, pika 3, rregullohet edhe dorëheqja me efekte përpara kohës normale që është ajo në fund të muajit pasardhës sipas pikës 2 të nenit 65.

Në këto kushte, rezulton që në rastin konkret jemi në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit të gjyqtarit {...} për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga ana e tij. Bazuar në motivet e paraqitura, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se i përket Këshillit të vlerësojë nëse jemi në kushtet e nenit 65/3 të ligjit nr.96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë’, pra nëse dorëheqja e paraqitur duhet t’i sjellë efektet përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të miratojë dorëheqjen e z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendosë:

Sipas variantit të parë:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.08.2020 (që është edhe situata normale, pra pa iu nënshtruar vlerësimit të shkaqeve të motivuara).

Varianti i dytë, sipas të cilit propozohet që Këshilli të:

1. Deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë për shkak të dorëheqjes së tij të motivuar nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020.

Ky është relacioni i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Tani i takon Këshillit të vendosë se para cilit nga variantet jemi në rastin konkret. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Shehu!

Në fakt, unë do doja të dija, pavarësisht varianteve, se cili është propozimi i Komisionit në këto dy variante?

**Marçela Shehu:** Po pra, janë dy propozime.

Secili variant ka një propozim. Varianti i parë ka propozimin që të deklarohet mbarimi i statusit dhe efektet e këtij urdhërimi fillojnë më 31 gusht dhe varianti i dytë është të deklarohet mbarimi i statusit dhe efektet e tij të jenë në kushtet e nenit 65/3, pra të fillojnë më datë 31.07.2020.

Nëse nuk ka diskutime, mund të votohet secili nga variantet, për të parë se cilën do mbështesë Këshilli.

**Naureda Llagami:** Ndonjë diskutim?

**Brikena Ukperaj:** A mundem zonja Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Tani... sepse sot ne në fakt në mbledhje plenare kemi trajtimin e dy kërkesave për mbarimin e statusit të magistratit. Një kërkesë na vjen si propozim Komisioni, që është kjo që sapo u relatua nga zonja Shehu dhe një kërkesë na vjen si propozim nga relatori, pra jo Komisioni.

Tani unë po pyes zonjën Shehu: - Është propozim Komisioni apo është propozim relatori kjo që sapo thatë? Sepse bëhet fjalë për një akt administrativ individual ku propozimi dhe përgatitja e projekt-aktit sipas ligjit, duhet të bëhet nga relatori i projekt-aktit. Marrë parasysh edhe atë që na është paraqitur në mbledhje plenare lidhur me përgatitjen ose mbarimin e statusit të zotit {...}, ku na vjen si propozim nga relatori, nga zoti Toro. Proceduralisht flasim.

**Marçela Shehu:** Atëherë, proceduralisht, ky është propozimi i relatorit dhe ky është propozimi i Komisionit, pasi është dakordësuar edhe në Komision, ka kaluar në këtë formë.

**Brikena Ukperaj:** Domethënë, ky është një propozim pa propozim i relatorit sepse që mbledhja plenare do ta vendosë këtë gjë, ne e dimë të gjithë. Nëse efektet e dorëheqjes do të jenë normale apo të përshpejtuara, kjo është një gjë që e vendos mbledhja plenare. Propozimi i relatorit cili është atëherë?

**Marçela Shehu:** O Brikena të lutem!

Kur Komisioni apo relatori ka ardhur me një propozim konkret, keni qenë ju bashkë me disa anëtarë të tjerë që jeni revoltuar duke thënë që kjo i përket mbledhjes plenare dhe nuk i përket Komisionit dhe as relatorit dhe pikërisht kjo ka qenë arsyeja që Komisioni dhe unë si relatore kam vlerësuar që ky propozim të vijë në dy variante dhe le ta vlerësojë mbledhja plenare.

Nëse do mendimin tim personal si relatore, unë mendoj që jemi në kushtet e variantit të dytë, të pranohet mbarimi i statusit të magjistratit z. {...} për shkak të dorëheqjes dhe efektet e tij të fillojmë më datë 31 korrik 2020.

**Naureda Llagami:** Atëherë, për të vijuar, ju si relatore, Marçela, propozoni që të hedhim variantin e parë në votim?

**Marçela Shehu:** Po meqë i dyti është më i ngushtë, duke pasur parasysh edhe praktikën e ndjekur deri tani, që kemi filluar nga më i ngushti tek i gjeri apo e kundërta.

Dakord. Unë propozoj që të fillohet nga varianti i dytë, që efektet të fillojnë më 31 korrik 2020.

**Erjon Muharremaj:** Ju kërkoj ndjesë zonja Kryetare.

Përpara se të fillojmë votimin, a mund të bëj një diskutim ju lutem?

**Naureda Llagami:** Po Erjon, patjetër!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Ajo që desha të përmend unë, përveç relatimit që bëri zonja Shehu, është që në datën 11.10.2018, me anë të kërkesës drejtuar Kryetarit të KLD-së, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, gjyqtari {...} ka kërkuar leje prindërore, mbështetur në nenin 24 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, për shkak se në datën 16.08.2018 kishte ardhur në jetë vajza e tij. Kërkesa e mësipërme është shqyrtuar në mbledhjen e KLD-së, në të njëjtën ditë, pra në datën 11.10.2018, si pika 3 (shtesë) e rendit të ditës, duke vendosur “Miratimi i kërkesës për leje prindërore për një periudhë 2-vjeçare, gjyqtarit {...}, për funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Afati i lejes

filloi në datën 01.11.2018 dhe përfundon në datën 31.10.2020, pra rreth 3 muaj pas datës së sotme. Pra është ende në fuqi.

Në datën 29.05.2019 është protokolluar panë KLGJ-së një kërkesë e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, njëkohësisht anëtarit të Kolegjit Zgjedhor që funksionon pranë të njëjtës gjykatë, z. {...}, me lëndë: “Mbi caktimin tim në shortin e Kolegjit Zgjedhor”. Me anë të kësaj kërkesë, gjyqtari i kërkonte KLGJ-së sqarimin e një situatë ekuivoke sipas tij, të krijuar në Kolegjin Zgjedhor, për shkak se edhe pse për të kishte të miratuar një leje prindërore nga ish-KLD-ja, nga ana e drejtuesve të gjykatës së apelit i ishte komunikuar se ai nuk ishte përjashtuar nga shorti për përzgjedhjen e përbërjes së trupit gjykues dhe relatorin e çështjeve të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, të cilat janë në kompetencë shqyrtimi të Kolegjit Zgjedhor.

Gjyqtari kishte parashtruar se nuk ishte jo vetëm logjike, por as ligjore, pjesëmarrja dhe përfshirja e tij në çështjet në shqyrtim në Kolegjin Zgjedhor sepse ndër të tjera (tani po citoj fjalët e gjyqtarit): “Ai ka marrë leje prindërore për fëmijën e porsalindur dhe aktualisht jeton në Bavari të Gjermanisë, ku është pajisur me leje qëndrimi. Në kuadër të integritimit në Gjermani, ka parapaguar dhe po ndjek kurset e nivelit të lartë të gjuhës gjermane, lejes së drejtimit gjermane për shkak të qëndrimit aty mbi 6 muaj, shkëputje nga të cilat do t’i sillnin dëme të pariparueshme. Ndërkohë që bashkëshortja e tij ndodhet në marrëdhënie pune në Gjermani dhe qëllimi për të cilin është marrë leja është pikërisht ai, që të përkujdeset ndaj fëmijës”, - këtu e mbyll citimin e zotit {...}.

Bazuar në arsyet e mësipërme, të parashtruara në kërkesën e gjyqtarit, si dhe në kuadër të garantimit të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, të sanksionuar në Kushtetutë, sipas të cilit, interesi më i lartë i fëmijës ka përparësi në të gjitha çështjet që lidhen me të, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, së bashku me dy koleget e nderuara të Komisionit, i propozuam Këshillit ndryshimin e projektvendimit nr. 52, datë 11.10.2018 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Bazuar në këtë propozim, të gjithë së bashku si Këshill, miratuam vendimin nr. 81, datë 05.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 52, datë 11.10.2018, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, duke e përjashtuar tërësisht zotin {...} nga ushtrimi i

veprimtarisë gjyqësore, në kuadër të lejes prindërore, përfshirë edhe atë si anëtar i Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, në mënyrë që të përkujdeset për fëmijën.

Ndërkohë që {...} është aktualisht me leje për t'u kujdesur për fëmijën, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar një kërkesë e dytë e tij që mban datën 17.07.2020, nëpërmjet të cilës kërkohet dorëheqja e parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe nga funksioni i gjyqtarit pranë gjykatës së apelit. Dorëheqja jepet për arsye të sulmeve politike ndaj tij, - ju lutem referojuni paragrafit 5 dhe 6 të kërkesës, -dhe për shkak se (tani po citoj fjalët e gjyqtarit), trupa (këtu dua të bëj një sqarim, bëhet fjalë për organet e rivlerësimit kalimtar), pra “trupa e cila gjykon mua dhe kolegët e mi të nderuar, të cilët kanë mbajtur pesha nga më të vështirat dhe të rëndat, është në nivel që lë shumë për të dëshiruar, si në aspektin profesional në formimin e përgjithshëm, si dhe lidhjet që kanë me politikën, 80% e tyre kanë qenë nëpunës të kësaj administrate”, - këtu e mbyll citimin dhe i jam referuar paragrafit të 8-të të kërkesës së gjyqtarit.

Në vijim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar një kërkesë e tretë e tij, që mban datën 23.07.2020, nëpërmjet të cilës kërkohet dorëheqja e parevokueshme nga statusi i gjyqtarit pranë gjykatës së apelit, me efekt të menjëhershëm, duke kërkuar që (tani po citoj fjalët e gjyqtarit) “Kjo kërkesë të merret parasysh në një kohë sa më të shkurtër dhe të përshtatshme, për të eliminuar çdo papajtueshmëri të statusit tim të magjistratit, pasi dorëheqja është e parevokueshme dhe plotësimi i këtyre formularëve (këtu po e ndërpres citimit për të sqaruar se bëhet fjalë për formularët që plotësohen nga kandidatët e mundshëm për zgjedhjet e ardhshme politike që do zhvillohen në qershor të vitit 2021 dhe i rikthehem citimit të gjyqtarit) ka një afat të shkurtër kohor”.

Pra në vlerësimin tim shikohet që kemi një larmishmëri motivesh, kërkesash nga i njëjti gjyqtar, ku së pari është dhe e kemi ende në fuqi një vendim të Këshillit për t'i mundësuar gjyqtarit përkujdesjen për fëmijën dhe nuk më rezulton, të paktën mua personalisht, që të ketë një kërkesë për shfuqizimin e këtij vendimi të Këshillit; arsyeja e dytë janë sulmet politike ndaj gjyqtarit dhe mangësitë si në aspektin profesional, ashtu edhe të formimit të përgjithshëm të trupës gjyqësore të organeve të rivlerësimit kalimtar; dhe kemi dhe një arsye të tretë që është eliminimi i papajtueshmërive të statusit të magjistratit dhe plotësimit të formularëve që kërkojnë një afat të shkurtër kohor.

Nga anëtarët e Komisionit, nëse munden, nëse kanë pasur kontakte të tjera, sepse unë nga shkresat nuk arrij dot të identifikoj motivin mbizotërues të të gjithë këtyre kërkesave të gjyqtarit, a ka ndonjë ndryshim rrethanash, pra gjyqtari nuk ka më nevojë të kujdeset për fëmijën? Ka ndonjë çështje tjetër emergjente që të arrijmë të kuptojmë cilat prej këtyre kërkesave prevalon? Këtë nëse mundet të na e sqarojnë anëtarët e Komisionit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Muharremaj!

Nëse ndonjëri nga anëtarët e Komisionit kërkon fjalën.

Atëherë, nuk do ta marrë fjalën asnjëri?

**Marçela Shehu:** Unë çfarë kisha për të thënë e thashë në relacion. Edhe propozimin konkret timin e bëra. Tani nuk di tjetër çfarë të them dhe çfarë të shpjegoj më shumë.

Ndërsa lidhur me lejen prindërore që ka marrë, Komisioni i Vlerësimit ka qenë edhe organi propozues, kështu që janë më mirë në dijeni se çfarë ka ndodhur me lejen prindërore të zotit {...}. Për mua, leja prindërore nuk ka lidhje me dorëheqjen nga statusi i magjistratit. Janë dy gjëra të ndryshme që nuk ndikojnë njëra-tjetrën. Kaq kisha.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Marçela!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, hedhim në votim projekt-aktin?

Sipas propozimit, fillojmë me variantin e dytë, i cili ka të bëjë me fillimin e urdhërimit që është data 31 korrik 2020. Pra hedhim në votim variantin e dytë.

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro, me të njëjtin arsyetim që kam bërë edhe në rastet analoge, të ngjashme.

**Dritan Hallunaj:** Pro, me të njëjtin arsyetim që kemi mbajtur edhe në rastet e ngjashme më përpara, por duke shtuar edhe pjesën që pavarësisht, afati maksimal i qëndrimit të mbajtjes së këtij statusi për gjyqtarin në fjalë është data 31 gusht dhe faktikisht dhe efektivisht ky gjyqtar nuk e ushtron detyrën, kështu që nuk është se ka ndonjë ndryshim të madh nëse raporti midis lejes prindërore apo pjesës tjetër si dhe nuk



ka ndonjë ndryshim të madh në afatin kohor. Pra jam pro që të përfundojë statusi në datën 31.07.2020. Faleminderit!

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro, me arsyetimin që motivi për t'u marrë me politikë është një motiv i bindshëm dhe i arsyeshëm që ai funksioni i ri që ai do të marrë dhe detyra e re është i papajtueshëm me detyrën që ai ka ushtruar deri tani. Për shkak të afateve që ligji ka parashikuar, kryesisht qëllimi i vendosjes së afatit, është mos dëmtimi i funksionalitetit të gjykatës, që në rastin e {...} nuk ekziston, për shkak se ai ka qenë me leje dhe vazhdon me leje. Për këtë shkak kërkoj që të jepet efekt të menjëhershëm dhe kërkesa t'i pranohet.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Kundër, me arsyetimin që motivet kontradiktore të paraqitura prej gjyqtarit, në të gjitha kërkesat që unë parashtrova gjatë diskutimit tim, ndërkohë që është në fuqi leja prindërore e dhënë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe e ndryshuar më pas nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk më duken arsye emergjente që të kërkojnë ndërhyrjen e Këshillit, për t'i dhënë efekt dorëheqjes së gjyqtarit para fundit të muajit pasardhës, pra para datës 31.08.2020. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Pro, me arsyetimin se në zbatim të nenit 65/3, në këtë rast nuk vihet në diskutim dhe as dëmtohet funksionaliteti i gjykatës. Gjyqtari është me leje prindërore, është me leje të papaguar dhe në vlerësimin tim, pasja e lejes prindërore nuk është kusht që e pengon gjyqtarin të heqë dorë nga statusi, kështu që jam dakord me variantin e dytë, me propozimin e relatores.

**Medi Bici:** Pro sepse shkak që paraqet gjyqtari është ligjor (pjesëmarrja në politikë); argumenti i dytë është se gjyqtari {...} ka 2 vjet që nuk punon, kështu që nuk e cenon funksionalitetin e gjykatës.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020. 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik

në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 30.07.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Ilir Toska**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.**
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e radhës të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}. Fjalën për relatimin e këtij projekt-akti ia jap zotit Toro.

**Alban Toro:** Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 24.07.2020, është depozituar një kërkesë me shkrim nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit.

Karriera e tij ka filluar me vendim nr. 14, datë 21.12.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me anë të të cilit ai është emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për të përfunduar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është transferuar me vendim nr. 189, 28.03.2006 të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në kërkesën e tij, të datës 24.07.2020, gjyqtari z. {...} ka kërkuar, ndër të tjera që: “... rrethanat dhe kushtet e reja, më diktojnë që këtë vendim ta marr sot, menjëherë dhe t’i përkushtohem detyrës së re sa më shpejt të jetë e mundur duke kërkuar nga ana juaj aplikimin e neneve 64 dhe 65 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit ne Republikën e Shqipërisë”...”.

Si motiv të kërkesës së tij z. {...} ka parashtruar faktin: “ ... sot më duhet të marr një vendim shumë të rëndësishëm për jetën time profesionale duke kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit dhe detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Tirane me dorëheqje, për shkak të një marrëdhënie tjetër pune, e cila do të fillojë ne datën 1 gusht 2020...” .

Si provë z. {...} të fillimit të marrëdhënies së punës së re ka paraqitur një kontratë pune të noterizuar me numër rep. 2370, nr. kol 797, datë 24.07.2020 e nënshkruar midis Shoqërisë “ALGAN” sh.p.k me cilësinë e punëdhënësit dhe z. {...} me cilësinë e punëmarrësit ku ndër të tjera palët kanë parashikuar në dispozitat e hyrjes në fuqi të kontratës datën 01.08.2020. Në këtë rast angazhimi i tij do të jetë jashtë sistemit gjyqësor.

Më poshtë ju kam paraqitur një pasqyrë të ngarkesës së trupës gjyqësore ku zoti {...} bën pjesë dhe të gjykatës respektive ku ai merr pjesë.

Zoti {...} kërkesën e tij e ka mbështetur në pikën 3 të nenit 65 të ligjit 96/2016 e cila përcakton se: “3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni”.

Pra kemi të bëjmë me institutin e dorëheqjes, që është parë edhe më parë në raste të ngjashme, i cili është një akt vullnetar dhe i cili vijon me rastin e mbarimit të statusit të magjistratit.

Aktualisht magjistrati kërkon të motivojë përshpejtimin e efekteve në datën 01.08.2020, për shkak se ai do të fillojë marrëdhënie të reja pune jashtë sistemit gjyqësor, duke paraqitur edhe aktet provuese përkatëse.

Në këto kushte, relatori, nëpërmjet këtij relacioni ju propozon të miratojë dorëheqjen e z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, me dispozitivin e mëposhtëm:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarës z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, ftoj kolegët, kemi ndonjë diskutim mbi propozimin e sjellë nga Komisioni?

**Brikena Ukperaj:** Zonja Kryetare, mund të them diçka?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Unë jam dakord me përmbajtjen e projekt-aktit, por tek pjesa e përgatitjes së projektvendimit, në pjesën hyrëse, duhet të hiqet togfjalëshi “për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi motivin bazuar mbi shkaqe shëndetësore”, se nuk kemi të bëjmë me motiv mbi shkaqe shëndetësore. Kaq kisha.

**Alban Toro:** Po Brikena, është lapsus për shkak të mbivendosjes mbi dokumente të tjera. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Këtë e rregullojmë në zbardhje.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit nëse nuk kemi më diskutime?

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord, duke sjellë këtu në kujtesë që shkak i paraqitur nga gjyqtari {...} është një shkak i vlerësuar dhe i pranuar si shkak për pranimin e dorëheqjes me efekt të menjëhershëm edhe në rast të magjistratëve të tjerë. Unë jam dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro, me të njëjtin arsyetim si zonja Shehu, në vijim të qëndrimeve të mëparshme të Këshillit për raste të ngjashme.

**Brikena Ukperaj:** Pro, për të njëjtin arsyetim, për shkak se ne tashmë kemi pranuar si shkak të motivuar këtë arsye të prezantuar nga zoti {...}, për fillimin e efekteve përpara se mbarimi i muajit pasardhës.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status. 2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020. 3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve. 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 30.07.2020)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në nivel apeli, të gjyqtarit {...}”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 12:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                            |                          |
|----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>  | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>      | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>  | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>10. Marçela Shehu</b>   | <b>(anëtare)</b>         |

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***zoti Ilir Toska.***



Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

## **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin në pozicion, në nivel apeli, të gjyqtarit {...}”.

*Naureda Llagami:* Atëherë, kalojmë tek çështja e fundit e rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, në mbledhjen e kaluar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas konstatimit të përfundimit të detyrimit kushtetues për qëndrimin në detyrë të zotit {...}, deri në emërimin e pasardhësit, KLGJ-ja në mbledhjen e datës 23 korrik publikoi pozicionet e lira, në mënyrë që zoti {...} të ushtronte të drejtën për t’u caktuar në nivel apeli.

Nga ana e relatorit na është vënë në dispozicion e gjithë praktika dokumentare, së bashku me aktin e propozuar. Nga zoti {...} rezulton që është përcjellë përzgjedhja e tij në lidhje me gjykatën që ai kërkon që të caktohet. Kështu që, për më shumë detaje do doja që të sqaroheshim nga ana e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, për projekt-aktin e propozuar, në kushtet që relatori sot, për arsye familjare, është në pamundësi për të qenë në mbledhje.

Marçela, Alban!

*Marçela Shehu:* Atëherë, bëhet fjalë për...? Se nuk dëgjova për shkak të internetit.

*Naureda Llagami:* Bëhet fjalë për projekt-aktin e përcjellë nga zoti Toska, si relator i çështjes, për mbledhjen e sotshme, i cili ka të bëtë me caktimin në pozicion, në nivel apeli, të gjyqtarit z.{...}. Në situatën që zoti Toska sot lajmëroi që është në

pamundësi për të qenë, për shkak të fatkeqësisë, unë propozoj që një nga anëtarët e tjerë të Komisionit ta relatojë projekt-aktin.

**Marçela Shehu:** Dakord. Në fakt ky është një projekt-akt i përgatitur nga zoti Toska me cilësinë e relatorit.

Atëherë është përgatitur projektvendimi përkatës lidhur me caktimin në pozicion, të gjyqtarit z.{...}, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

“Me vendimin nr.260, datë 23.07.2020, mbi kërkesën e gjyqtarit z.{...}për caktimin në pozicion në nivel apeli, pas përfundimit të detyrimit kushtetues për qëndrimin në detyrë në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur:

“1. Publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë, si më poshtë: në Gjykatën e Apelit Tiranë; në Gjykatën e Apelit Durrës; në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë; në Gjykatën e Apelit Korçë; në Gjykatën e Apelit Shkodër; në Gjykatën Administrative të Apelit.

2. Gjyqtari {...} ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda datës 28 korrik 2020”.

Vendimi si më lart iu komunikua rregullisht gjyqtarit z.{...}, duke u ftuar ai të ushtrojë, në përputhje me nenin 62, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të drejtën e zgjedhjes së një prej pozicioneve të lira të publikuara sipas vendimit nr.260, datë 23.07.2020.

Me kërkesën e protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.3491/3 prot., datë 28.07.2020, në ushtrim të së drejtës së tij, gjyqtari z.{...} ka zgjedhur të caktohet në pozicion në nivel apeli pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në këtë rast, në funksion të kërkesave të pikës 1, të nenit 62, të Ligjit nr. 96/2016 i ndryshuar, sa i përket plotësimin të kriterëve për pozicionin e zgjedhur, pra në Gjykatën Administrative të Apelit, gjyqtari z.{...} i ka bashkëlidhur kërkesës disa urdhra të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, fotokopje të njësuar me origjinalin, ndër të tjera konkretisht:

Urdhrin nr.102 prot., datë 08.05.2013, “Për ndarjen e gjyqtarëve në Kolegje”, sipas të cilit ai është caktuar në Kolegjin Civil;

Urdhrin nr.223 prot., datë 02.10.2013, “Për formimin e Kolegjeve Civile të përbëra prej tre gjyqtarësh”, sipas të cilit ai është caktuar në përbërjen e një prej Kolegjeve Civile;

Urdhrin nr.241 prot., datë 01.11.2013, “Për ndarjen e gjyqtarëve në Kolegje”, sipas të cilit ai është caktuar në Kolegjin Administrativ;

Urdhrin nr.241/1 prot., datë 04.11.2013, “Për një shtesë në Urdhrin nr.241, datë 01.11.2013, Për ndarjen e gjyqtarëve në Kolegje”, sipas të cilit “Gjyqtarët relator të Kolegjit Civil të caktuar për gjykimin e çështjeve me natyrë administrative dhe gjyqtarët e Kolegjit Administrativ të caktuar për të gjykuar çështjet me natyrë civile, në përputhje me ndarjen e gjyqtarëve në kolegje, të këmbejnë reciprokisht midis tyre çështjet gjyqësore civile dhe administrative, të cilat nuk janë shqyrtuar akoma në dhomën e këshillimit, sipas skemës së mëposhtme ...”;

Urdhrin nr.215 prot., datë 12.09.2014, “Për formimin e Kolegjeve Administrative të përbëra prej tre gjyqtarësh”, sipas të cilit ai është caktuar në përbërjen e një prej trupave gjykues të Kolegjit Administrativ;

Urdhrin nr.217, datë 04.09.2017, “Për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje dhe marrjen e disa masave organizative për menaxhimin gjyqësor”, sipas të cilit ai është caktuar në Kolegjin Administrativ.

Referuar dokumentacionit shoqëruar të kërkesës, rezulton se gjyqtari z.{...}, deri në vitin 2013, ka qenë caktuar në Kolegjin Civil, ndërsa Gjykata e Lartë deri në këtë kohë ka qenë e organizuar në dy kolegje, atë civil dhe penal, ku kolegji civil gjykonte edhe çështjet me natyrë administrative. Më pas, mbas datës 01.10.2013, kur Gjykata e Lartë është organizuar në tre kolegje, atë civil, penal dhe administrativ, z.{...} është caktuar në Kolegjin Administrativ, ku ka vijuar të paktën deri në fund të vitit 2018, ndërsa më pas, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve në detyrë të Gjykatës së Lartë, praktikisht ata nuk kanë qenë të ndarë kolegje. Nga sa rezulton, z.{...} ka përvojë të përgjithshme si gjyqtar (i Gjykatës së Lartë) më shumë se shtatë vjet, nga të cilat më shumë se pesë vjet në fushën e të drejtës administrative, duke plotësuar kështu kriteret për pozicionin e zgjedhur, pra në Gjykatën Administrative të Apelit, referuar përcaktimeve të pikës 4, të nenit 47, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas shkresës nr.1705 prot., datë 28.07.2020, të Gjykatës së Lartë, “... marrëdhëniet financiare të z.{...} i janë ndërprerë në datë 08.07.2020 ...”. Nisur nga kjo, nga dita e nesërme e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare në Gjykatën e Lartë, referuar pikës 3, të nenit 62, të Ligjit nr. 96/2016, z.{...} i lind e drejta e pagës në pozicionin në nivel apeli ku duhet të caktohet.

Sa më sipër, në konsideratë dhe respektim të vendimmarrjes së mëparshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendimit nr.260, datë 23.07.2020, në cilësinë e relatorit, është përgatitur nga zoti Toska, se zoti Toska është relator i këtij projektvendimi, është përgatitur projektvendimi “Për caktimin në pozicion në nivel apeli të gjyqtarit z.{...}”.

Sillet në vëmendje të Këshillit se miratimi i këtij projektvendimi afekton të paktën një nga procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallura me vendimet e tij nr.187 dhe nr.188, datë 28.05.2020, shkak për të cilin Këshilli do të duhet të disponojë në vijim. Ndërkohë, deri në një vendimmarrje të Këshillit për një nga këto procedura ngritje në detyrë dhe zgjidhjen e situatës që krijohet, nuk do të jetë e mundur përmbyllja e verifikimeve të tre kritereve formale të atyre kandidatëve që kanë kandiduar në procedurën respektive të ngritjes në detyrë.

Sa i përket projektvendimit, ai është i strukturuar në pesë pika.

Pika 1 bën fjalë për caktimin e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pika 2 lidhet me efektet juridike.

Në pikën 3 përcaktohet fillimi i efekteve financiare më datë 09.07.2020.

Pika 4 lidhet me komunikimin e vendimit.

Dhe në pikën 5 e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit.”

Ky është projektvendimi dhe relacioni i përgatitur nga zoti Ilir Toska, por që ai për shkak të një fatkeqësie familjare nuk është prezent dhe unë e parashtrova përpara jush.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit Marçela!

Atëherë, nëse kemi ndonjë diskutim përpara se ta hedhim projekt-aktin në votim.

**Medi Bici:** Vetëm një saktësim. Jam dakord me atë që thotë Marçela.

Desha të di, pagesa i fillon nga dita që i shkëputet paga në Gjykatë të Lartë?

**Naureda Llagami:** Po! Me sa duket, po!

Sepse kemi një shkresë që ka ardhur nga Gjykata e Lartë, ku thuhet që pagesa i është ndërprerë më datë 8 korrik 2020 dhe efektet financiare të vendimit janë më datë 9 korrik 2020.

**Medi Bici:** Jam i qartë.

**Naureda Llagami:** Atëherë, nëse kemi ndonjë diskutim tjetër?

Kalojmë aktin në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, unë dua të sqaroj votën time, jam pro, por dua të shpjegoj diçka. Unë kam qenë kundër në seancën e kaluar kur vendosëm në parim se çfarë vendesh do i viheshin në dispozicion zotit {...} dhe kam votuar kundër këtij varianti, që t'i viheshin në dispozicion pozicionet për të cilat kishte filluar procedura, me arsyetim se kjo situatë cenonte të drejta e magistratëve të tjerë që kanë filluar dhe kanë kandiduar në këtë pozicion, dhe cenon parimin e sigurisë juridike. Por në kushtet kur Këshilli, me shumicë votash votoi pro këtij varianti, unë pas këtij momenti procedural, votoj për këtë pjesë të procedurës; dhe përderisa Këshilli, me shumicë votash ia dha mundësinë që ta zgjedhë këtë pozicion, unë nuk shikoj ndonjë pengesë që zoti {...} ta marrë këtë pozicion; dhe për këtë arsye votoj pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Alban Toro:** Atëherë, jam kundër këtij projekti të propozuar, për shkak sepse është në kundërshtim të hapur me parimet kryesore të Kushtetutës siç janë siguria juridike dhe pritshmëria ligjore, si dhe për më tepër interferon me garancitë statuale që kanë gjyqtarët, madje në mënyrë të veçantë ato aktualisht që kanë marrë pjesë në konkurrimin për këtë pozicion të lirë të cilit i është dedikuar këtij magistrati, dhe cenon në mënyrë të rëndë sistemin e garancive personale të cilat janë vendosur në funksion të pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor, garancitë ligjore që ka parashikuar statusi i gjyqtarëve, në lidhje ndër të tjera edhe me mënyrën e emërimit dhe procedurën e emërimit të tyre, të cilën kjo vendimmarrje e cenon, jo vetëm nga pikëpamja materiale por edhe moralisht, ne nuk mund t'i themi trupës gjyqësore në konkurrim që, aktualisht

konkurrimi juaj stopohet sepse aty do të emërojmë dikë tjetër. Kështu që në përfundim them që Zoti e ruajttë gjyqtarin.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Kundër. Duke qenë se unë isha kundër edhe në mbledhjen e kaluar për t'ia vënë zotit {...} bashkë me gjykatat e tjera për të zgjedhur, isha kundër, për shkak se për këtë gjykatë kishte filluar procedura e ngritjes në detyrë dhe ishte një pozicion për të cilin janë në garë tashmë magjistratët, dhe duke qenë se unë votova kundër që ky pozicion të shpallej i lirë, i hapur dhe në dispozicion të zotit {...}, rrjedhimisht jam edhe kundër caktimit të tij në këtë pozicion.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion të gjyqtarit z.{...} pranë Gjykatës Administrative të Apelit. 2. Efektet juridike të vendimit sa i përket ushtrimit të detyrës pranë Gjykatës Administrative të Apelit, fillojnë nga data e njoftimit. 3. Efektet financiare të vendimit fillojnë nga data 09.07.2020. 4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, me miratimin e këtij projekt-akti përfunduar edhe çështjet që kishim parashikuar për të shqyrtuar në mbledhjen e sotshme. Ju uroj punë të mbarë dhe pse jo, pushime të mbara! Mirupafshim!

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**